

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

STATUT SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUR

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në mbështetje të nenin 49 të,” Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodit Civil, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, ligjit Nr. 131/2015 Për Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përputhje të plotë me këtë statut dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

PËRKUFIZIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është një shoqëri tregtare, e themeluar nga persona fizikë ose juridikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.”.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara nuk mund të ofrojnë kuotat e tyre si mjete investimi për publikun e gjerë. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, marrëdhëniet ndërmjet ortakëve mund të përcaktohen në statutin e shoqërisë. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta). Statuti përcakton mënyrat e shlyerjes së kontributeve. Ortakët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar i vlerësojnë kontributet në natyrë në marrëveshje të ndërsjella me njëri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre në para. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, secili prej ortakëve mund t’i drejtohet gjykatës përkatëse, për të ngarkuar një ekspert vlerësues, me një vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me të dhënat e tjera të kërkuara për regjistrim.

KREU 1 THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI, THEMELUESIT

1.1 Sot, më, 01.10.2023, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

1.2 **DEDJA & SALILLARI SHPK;**

1.3 Themeluesit e shoqërisë janë:

- Z. Bashkimit Salillari i biri i Kamberit dhe i Zybes i lindur në Kapindo dhe banues në, lagjen 3, Rr,” Egnatia,” Pll.1039, K.3. Durrës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr. F20130087T.

NENI 2 OBJEKTI

Shoqëria do të kryejë aktivitetin sajë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si mëposhtë:

Ofrimin e shërbimeve për të tretët, individ, persona fizik e juridik, në institucionet publike apo

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

private, që ofrohen nëpërmjet sistemit elektronik (on-line) apo fiksht, Konsulenc në përpilimin dhe ndjekjen e praktikës në mbylljns e aktiviteteve tregtare, për të tretët, Konsulenc, përpilimin dhe ndjekjen e praktikës, së falimentimit të aktiviteteve tregtare, për të tretët. Konsulenc, përpilim dhe ndjekjen e praktikave në çështjet e prokurimeve publike, për të tretët. Konsulenc dhe Ndërmjetësimin të Pasurive të Paluajtshme dhe Luajtëshm, në shit-blerje dhe dhënies me qera të pasurive, të reja dhe të përdorura, Shërbime financiare, Veprimtari financiare të transferimit të parave në emër dhe për llogari të Subjektit financiar-jobankë. Këmbim Valutor, Veprimtari të Agjentit Komisioner. Shërbime përkthimi. Sigurimin ndaj dëmeve dhe Risigurimet dhe ndërmjetësimin të Sigurimeve dhe të Risigurimev. Studio ligjore "Avokati", Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit objekte industriale, Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, pjesëmarrje në fushën industriale turistike, nëfushën agroturizëm, Veprimtari në fushën e strukturave akomoduese hoteleri, bar, restorant, me plan shërbim të personalizuar dhe plan shërbimi" çdo gjë e përfshirë" (all inclusive), shazllone, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, pistë në det me lokacion bar-restorant vendbazim për mjete ujore, motorrike dhe jo motorrike. Shërbim catering dhe delivery. Shërbime programimi softëare. Tregtimi i pajisje elektronike. Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim të punimeve të ndërtimit apo të çdo fushe qoftë kjo sipas liçencës përkatëse. Zhvillimin e veprimtarisë ndërtimore dhe të rikonstruksionit sipas liçensës së shoqërisë. Shoqëri Hidroteknike, Prova/analiza laboratorike për materialet e ndërtimit dhe strukturën ndërtimore,veprimtari në restaurime të monumenteve të trashëgimisë kulturore. Veprimtari Arkeologjike, Shërbimin e Projektimit, Mbikqyrjes, Kolaudim dhe të Zbatimit në Auditimit të Energjisë në ndërtesa, procese industriale, transportit dhe të Menaxherit të Auditimit Energjistik, Shoqëri ESCO, Veprimtari të Studim Projektimit, Zbatim Mbikqyrje dhe Kolaudim të Sismologjisë, Gjeologjisë dhe Hidrogjeologjisë Inxhenjerike, etj. Projektim, Mirëmbajtje, Kolaudim dhe Çertifikim të impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensor, shkallë lëvizëse etj) Shërbime higjeno-sanitare. Projektim, mirëmbajtje, kolaudim dhe Çertifikim të impianteve Elektrik. Shërbime ekspertize: Studim dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave të çdo lloji. Kodi 1.2 A. Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile sipas grupit të liçencave Kodi 1.2.A. Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë. Shpues profesionist për ujë Kodi III.7.B. Vlerësim të pasurive të paluajtshme Tokë-Truall, Tokë-Arë, Ndërtesa. Hartimin e Raporteve Paraprake dhe të Thelluar të VNM së. Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Auditim Mjedisor Kodi III.2.A; Shërbime të matjeve së cilcisë të zhurmës të ajrit dhe të ujit sipas liçencës përkatëse etj Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet energjetike Kodi IV.4.C. Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet minerare Kodi IV.4A. Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet energjetike Kodi IV.4B.Shërbime ndërhyrëse në raste emergjencash Kodi I.2.B, Tregtimin me shumicë të produkteve të kancelarisë dhe shërbimeve të kësaj fushe si fotokopime, printime etj.

NENI 3

KOHËZGJATJA

- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë wshtw pa afat;
- 3.2 Përfundon në një nga format e parashikuara në ligj.

NENI 4

SELIA

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën, Lagja 3, Rr," Ramazan Jella", Pll. 1125, K.1, Pasuria 3/371-N2, ZK,8514, Durrës.
- 4.3 Hapja dhe adresat e zyrave të përfaqësimit do të vendosen me vendim të asamblesë;
- 4.4 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon salillaribashkim@gmail.com

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

KREU II KAPITALI DHE KUOTAT

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

ORTAKU THEMELUES:

5.1 z. Bashkim Kamber Salillari : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

5.3 Kontributi i ortakut z. Bashkim Kamber Salillari, është në para dhe në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

5.4 Kontributi mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

NENI 6 ZOTËRIMI I KUOTAVE

6.1 Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, **DEDJA&SALILLARI SHPK**, mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

6.2 Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona do të trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre do të ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët dhe do të përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

6.3 Personat që zotërojnë një kuotë të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar , **DEDJA&SALILLARI SHPK** do të merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo kuotë dhe të drejtat e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo.

6.4 Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person do të krijojnë pasoja ndaj për të gjithë zotëruesit e kuotës edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

6.5 Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit dhe kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk do të përbëjë letër me vlerë.

6. Nëse personat që zotërojnë një kuotë nuk do të arrijnë një marrëveshje, sipas pikës 3 të këtij neni, atëherë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë.

NENI 7 FITIMI DHE KALIMI I KUOTAVE

7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **DEDJA&SALILLARI SHPK**, dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit do të rregullohen me kontratë. Kontrata për kalimin e kuotës do të hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk do të përbëjë kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë,

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.”.

7.3 Kalimi kuotave, do të kushtëzohet veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

NENI 8

PJESTIMI I KUOTAVE DHE TRANSFERIMI I TYRE

8.1 Vetëm në rastin e një ortaku kuotat nuk do të pjestohen, por në rast se do të ketë më shumë se një ortak, kuotat do të pjestohen për shkak të kalimit të tyre.

8.2 Dispozitat e nenit 73 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

NENI 9

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

9.1 Kapitali i shoqërisë, **DEDJA&SALILLARI SHPK**, do të mund të zmadhohet, nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribut sipas kërkesës së administratorit.

9.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

9.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit do të preki ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

KREU III

MARRËDHËNIET E SHOQËRISË ME ORTAKËT

NENI 10

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

10.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë me vendim asambleje, dhe fitimi do të shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 11

KUFIZIMET E SHPËRNDARJES DHE ÇERTIFIKATA E AFTËSISË PAGUESE

11.1 Shoqëria do të shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

11.2 Administratori/Administratorët do të lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila do të konfirmojë shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori/administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

11.3 Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.”.

11.4 Administratori/administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e çertifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.

NENI 12

PËRGJEGJËSIA PERSONALE PËR SHPËRNDARJET E NDALUARA

12.1 Administratori/ët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një çertifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 11.2 të statutit dhe të nenit 77 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

12.1 Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të çertifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjëndjen e pa-aftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 1 të nenit 11 ose të nenit 77 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjëndje.

NENI 13

RIKTHIMI I SHPËRNDARJEVE TË NDALUARA

13.1 Paditë e shoqërisë, siç parashikohet në nenin 78 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, mund të ngrihen edhe sipas pikës 3 të nenit 10 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

13.2 Parashkrimi i padive, sipas pikës 13.1 të këtij neni, nis në datën kur është kryer shpërndarja e ndaluar.

NENI 14

ANULLIMI I KUOTAVE NGA SHOQËRIA

14.1 Shoqëria ka të drejtën për të anuluar një kuotë. shkaqet dhe procedurat për anulimin e likuidimin e kuotës do të parashikohen në statut.

14.2 Kuota to të anulohet në rast se ortaku qe disponon kuotën do të kryejë veprime me keq dashje në interes të shoqërisë.

14.2 Kuota mund të anulohet në çdo rast me miratimin e ortakut përkatës ose me 2/3 e votave të të gjithë ortakëve.

14.3 Në rast se nuk arrihet anulimi me miratim automatikisht shoqëria do ti drejtohet gjykatës miratimin për anulimin e kësaj kuote.

14.3 Të drejtat e detyrimit, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anulimin e saj.

KREU IV

ORGANET E SHOQËRISË ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 15

TË DREJTAT DHE DETYRIMET

15.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit/administratorëve;

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

- ç) emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar apo statuti.

15.2 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

15.3 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm.

15.4 Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

15.4 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme, nuk mund t’i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që i ka fituar të drejtat në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 16

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

16.1 Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

16.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori/administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 i ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

16.3 Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

16.4 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

16.5 Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 10%

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
16.6 Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

16.7 Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 16.4 e 16.5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.

16.8 Në rastet e parashikuara në pikat 16.3 deri në 16.5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

NENI 17

MËNYRA E THIRRJES

17.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dhe me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

17.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 17.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 18

KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

18.1 Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, ortaku/ ortakët kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

18.2 Nëse, në kundërshtim me pikën 18.1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej ortakut/ortakve nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratori/administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

18.3 Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 18.1 e 18.2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

18.4 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë ç'do fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

NENI 19

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

19.1 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

19.2 Administratori/Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme apo të zakonshme.

19.3 Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme apo të zakonshme, por është i vlefshëm, për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 20 KUORUMI

20.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50 % qind të numrit total të votave, që janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

20.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 20.1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 21 MARRJA E VENDIMEVE

21.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në këtë statut dhe të nenit 86 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

21.2 Për çështjet e tjera të renditura në nenin 15 të këtij statuti dhe të nenit 81 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

21.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

NENI 22 E DREJTA E VOTËS

22.1 Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

22.2 Për ortakun/ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i tij/tyre

22.3 Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakut/ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

22.4 Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakut/ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet vetëm me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakut/ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

22.5 Ortaku/Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

NENI 23

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

23.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

23.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

NENI 24

PROÇESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

24.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme do të regjistrohen në procesverbal. Administratori/Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

24.2 Procesverbali do të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

24.3 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

24.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

24.5 Në përputhje me nenin 90 pika 5 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Nëse shoqëria ka të publikuar një faqe në internet, admistratori/administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

NENI 25

HETIMI/HETIMET E POSAÇME

25.1 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

25.2 Ortaku/Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 % për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të këtij statuti. ortaku/ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

emërimin e ekspertit. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakut/ortakëve vlerësohet e refuzuar.

25.3 Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortaku/ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 25.2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

25.4 Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 25.2 e 25.3 të këtij neni, shoqëria tregtare do të përballojë kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

25.5 E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 25.1 e 25.2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

25.6 Kreditori, i cili në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 25.2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

NENI 26

SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TË PARREGULLTA DHE DËMSHPËRBLIMI

26.1 Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marr me shumicën e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit 21, të këtij statuti, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar ose statuti ndaj administratorëve apo ortakut/ortakëve.

26.2 .Ortaku/ Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë dhe/ose kreditorët e shoqërisë, të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrime në një vlerë jo më të vogël se 5 % për qind të kapitalit, mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë drejtpërdrejt, përpara gjykatës kompetente, padi në emër të shoqërisë, për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakut/ortakëve apo kreditorëve të përcaktuar më sipër vlerësohet e refuzuar.

26.3 Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

26.4 Ortaku/Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 26.2 të këtij neni, mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen sipas ligjit.

26.5 Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorit/administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacënuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

26.6 Ortaku/Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 26.2 e 26.4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

26.7 Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 91 të ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar zbatohet edhe për këto padi.

NENI 27

TË DREJTAT E LIDHURA ME KUOTËN

27.1 Ortaku/Ortakët, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

NENI 28

NDALIMI I KUFIZIMEVE

28.1 Janë të pavlefshme dispozitat e statutit, që kufizojnë ose përjashtojnë ndonjë nga të drejtat e ortakëve ose të kreditorëve, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 91, 92 e 93 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe dispozitat, që parashikojnë kufizime të përgjithshme të veprimeve të përcaktuara në këto nene.

28.2 Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cënojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 91, 92 e 93 të ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

KREU V

ADMINISTRATORËT

NENI 29

EMËRIMI, SHKARKIMI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET

29.1 Asambleja e përgjithshme mund të emërojë një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. afati i emërimit, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit/administratorëve, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, dhe u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

29.2 Administratori/Administratorët e shoqërisë tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë dispozit është e pavlefshme.

Administratori/Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura në asamblenë e përgjithshme;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

dh) të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) të raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj ose në këtë statut.

f) Administratorët e caktuar duhet të jenë vetëm bashkarisht për kryerjen e veprimeve të transaksionit të tërheqjes kesh apo të transfertave të parave dhe likuidimeve të faturave apo çdo vbeprimi tjetër ndaj të tretëve që janë subjekte juridike apo fizike private lidhur me numrin ellogaris që do të hapet pranë bankave. Kanë të drejtë të kryejnë çdo veprim veç e veç vetëm lidhur me pagesat që rrjedhin nga detyrimi për pagimin e taksave vendore taksave qëndrore, gjobave lidhur me këto taksa, sigurimeve shoqërore e shëndetsore, rinovimin e licencave të shoqërisë apo çdo veprim që lidhet me mandat pagesat, të lëshuara nga Organet dhe institucionet shtetore dhe kalimin e pagave të punonjësve. Të drejtat dhe kufizimet e mësipërme me llogarit bankare, do të vlejnë edhe për llogarit bankare që do të hapen në të ardhmen nga shoqëria

29.3 Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, administrator/administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

29.4 Nëse asambleja e përgjithshme do të emërojë më shumë se një administrator, administrimi i shoqërinë do të përcaktohet nga rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, të cilat mund të parashikojnë ndryshe.

29.5 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin/administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

29.6 Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

29.7 Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrën Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar.

29.8 Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas ligji.”.

NENI 30 PËRFAQËSIMI

30.1 Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

30.2 Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorit/administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

30.3 Tagrat e përfaqësimit të administratorit/administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre do të njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

NENI 31 SHPËRBLIMI

31.1 Shpërblimit bazë të administratorit/administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme ato do të përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

31.2 Shpërblimi, sipas pikës 30.1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit/administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

31.3 Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit/administratorëve në masën e përshtatshme.

31.4 Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit/administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 32 DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

32.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar, administratori/administratorët detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në këtë statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në këtë statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;
- dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

32.2 Administratori/Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

32.3 Nëse administratori/administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 32.1 e 32.2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori/Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

32.4 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori/administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthejnë ortakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.

32.5 Dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

KREU VI PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 33 LARGIMI I ORTAKUT PËR SHKAQE TË ARSYESHME

33.1 Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

33.2 Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

33.3 Administratori/Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 33.2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likukdohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

33.4 Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

33.5 Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

33.6 Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

NENI 34 PËRJASHTIMI I ORTAKUT

34.1 Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

34.2 Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

- a)** me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b)** me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c)** përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç)** me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

34.3 Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar. 33.4 Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

34.5 Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

34.6 Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

NENI 35

PASOJAT E LARGIMIT DHE PËRJASHTIMIT

35.1 Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

35.2 Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

NENI 36

SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

36.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në këtë statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

36.2 Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 36.1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e ortakëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 21 të këtij titulli dhe nenit 87 të ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

36.3 Në rast mosveprimi të asamblesë së ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", dhe "dh", të pikës 36.1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund, në çdo kohë, t'i drejtohet gjykatës për të konstatuar prishjen e shoqërisë.

36.4 Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 36.1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 36.3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundur të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

36.5 Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 36.1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

36.6 Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 36.1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të dispozitave ligjore.”.

NENI 37

REGJISTRIMI I SHPËRBËRJES

37.1 Administratori/Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjyqësor, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin **Qendrës Kombëtare të Biznesit** për regjistrim.

NENI 38

LIKUJDIMI NË GJËNDJEN E AFTËSISË PAGUESE

38.1 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas ligji.

KREU VIII

RIORGANIZIMI I SHOQËRIVE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

NENI 39

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

39.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

39.2 Shoqëria mund të riorganizohet vetëm pasi të ketë qenë e regjistruara për të paktën një vit.

39.3 Bashkimi i shoqërisë kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.

KREU IX

BASHKIMI

PËRKUFIZIM

Shoqëria mund të bashkohet nëpërmjet:

- Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëjës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
- Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

NENI 40

BASHKIMI ME PËRTHITHJE

MARRËVESHJA DHE RAPORTI I BASHKIMIT

40.1 Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë/shoqërive, për procedurën e bashkimit harton një projekt marrëveshje me shkrim, ku do të përcaktojë të paktën:

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

- a) forma, emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërisë/shoqërive që marrin pjesë në bashkim;
- b) raporti i këmbimit të kuotave apo aksioneve dhe çdo shumë e pagueshme në para;
- c) kushtet e ndarjes së kuotave apo aksioneve të shoqërisë përthithëse;
- ç) data, duke nisur nga e cila zotëruesit e këtyre kuotave apo aksioneve kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit, si dhe çdo kusht i posaçëm që ndikon në ushtrimin e kësaj të drejte;
- d) data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse;
- dh) të drejtat që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të kuotave, aksioneve, të drejtat e veçanta apo titujt e ndryshëm nga aksionet e shoqërisë/shoqërive të përthithura apo çdo masë tjetër e parashikuar në lidhje me ta;
- e) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ë) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.

40.2 Përfaqësuesi/Përfasuesit ligjorë i shoqërisë dhe i secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në bashkim do të hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e, në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta. Në raport do të përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti gjithashtu duhet të përshkruajë edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.

40.3 Shoqëria dhe çdo shoqëri, që do të marri pjesë në bashkim, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, depoziton pranë **Oendrës Kombëtare të Biznesit** dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, projekt-marrëveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen në mënyrë të detyrueshme për të paktën tri vitet e fundit.

40.4 Shoqëria/shoqërit, që përmbushin kërkesën e pikës 3, të nenit 214, të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, por që kanë qenë të regjistruara për më pak se tre vjet, paraqesin dokumentacionin sipas pikës 40.3, të këtij neni, vetëm për vitet që kanë qenë të regjistruara.

40.5 Nëse viti i fundit ushtrimor, të cilit i referohen pasqyrat financiare, të përmendura në pikat 40.3 ose 40.4, të këtij neni, është mbyllur në një datë e cila është më e hershme se gjashtë muaj përpara datës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit, atëherë, me përjashtim të rastit kur sipas ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 , “Për titujt”, shoqëria ka hartuar dhe u ka vënë në dispozicion aksionarëve raporte financiare gjashtëmujore, shoqëria do të hartojë gjithashtu pasqyra kontabël për gjendjen e shoqërisë në një datë, e cila nuk duhet të jetë më e hershme se dita e parë e muajit të tretë përpara datës së hartimit të projekt-marrëveshjes së bashkimit dhe i publikon ato sipas pikës 40.3 të këtij neni.

40.6 Përfaqësuesi/Përfaqësuesit ligjorë të secilës shoqëri pjesëmarrëse në bashkim do të duhet të njoftojnë asamblenë e përgjithshme të shoqërisë së tyre, si dhe organet e administrimit të shoqërive të tjera që marrin pjesë në bashkim, më qëllim njoftimin e asambleve të përgjithshme të shoqërive përkatëse në lidhje me çdo ndryshim thelbësor në aktivet dhe pasivet e shoqërisë, nga data në të cilën është hartuar projekt-marrëveshja e bashkimit, deri në datat e caktuara për mbledhjet e asambleve të përgjithshme që do të vendosin mbi miratimin e projekt-marrëveshjes së bashkimit.

40.7 Detyrimi për hartimin e raportit të përmendur në pikën 40.2, të pasqyrave kontabël të përmendura në pikën 40.5, si dhe të njoftimit sipas pikës 40.6, të këtij neni, mund të përjashtohet

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

me miratimin e të gjithë ortakëve/aksionarëve me të drejtë vote të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim.”.

NENI 41

RAPORTI EKSPERTËVE

41.1 Përfaqësuesi/Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që do të marrin pjesë në bashkim, do të caktojnë ekspertë të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit. Ekspertët do të caktohen për secilën shoqëri ose në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, që marrin pjesë në bashkim me marrëveshje. Ata do të mund të caktohen edhe nga gjykata përkatëse, nëse kjo do të kërkohet nga përfaqësuesit ligjorë.

41.2 Ekspertët do të hartojnë një raport me shkrim, ku duhet të deklarojnë, ndër të tjera, nëse, sipas mendimit të tyre, raporti i këmbimit të aksioneve/kuotave është i drejtë dhe i arsyeshëm. Në deklaratë ekspertët duhet të shprehen, në veçanti:

- a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;
- b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;
- c) për vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur.
- ç) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, raporti i vlerësimit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur sipas kësaj metode i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit.”.

41.3 Ekspertët do të marrin nga shoqëria dhe shoqëritë që bashkohen të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse, si dhe të kryejnë të gjitha hetimet e nevojshme.

41.4 Raporti i ekspertëve do të depozitohet pranë **Qendrës Kombëtare të Biznesit** dhe do të publikohet në faqen e internetit, nëse ka, të paktën një muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, në lidhje me vendimin e përcaktuar në nenin 218 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

41.5 Përfshirja e ekspertëve, sipas pikave 41/1/2/3 e 4 të këtij neni, mund të përjashtohet nëse të gjithë aksionarët/ortakët e shoqërisë dhe shoqërive që bashkohen japin miratimin.

NENI 42

MIRATIMI I MARRËVESHJES SË BASHKIMIT

42.1 Projekt marrëveshja e bashkimit do të prodhojë efekte vetëm pasi të jetë miratuar nga ortakët apo aksionarët e të gjitha shoqërive, që marrin pjesë në bashkim. Projekt marrëveshja e bashkimit miratohet, përkatësisht, në përputhje me shumicën e parashikuar e në pikën 1 të nenit 87 dhe pikën 1 të nenit 145 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

42.2 Kur nga projekt marrëveshja e bashkimit preken të drejtat e aksionarëve/ortakëve të veçantë apo të drejtat, që rrjedhin nga aksione të kategorive të veçanta, atëherë projekt marrëveshja do të nënshtrohet, një votimi të veçantë, i cili merret me shumicën e tre të katërtave të votave të secilës kategori aksionesh të prekura.

42.3 Secili aksionar apo ortak i shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, ka të drejtë të kërkojë e të marrë nga shoqëria, pa pagesë, kopje të plotë apo të pjesshme të dokumenteve, në bazë të të cilave kryhet bashkimi, sipas neneve 216 dhe 217. të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar , Nëse aksionari apo ortaku ka pranuar kryerjen e njoftimeve

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

nga shoqëria në formë elektronike, këto dokumente mund t'i dërgohen me postë elektronike.”.

42.4 Shoqëria do të përjashtohet nga detyrimi për të mbajtur në dispozicion në selinë e saj dokumentacionin që duhet t'u jepet ortakëve apo aksionarëve, sipas pikës 42.3, nëse për një periudhë të pandërprerë, e cila nis një muaj përpara datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme për miratimin e projekt marrëveshjes së bashkimit, ky dokumentacion u vihet në dispozicion ortakëve apo aksionarëve, pa pagesë, për t'u parë, shkarkuar apo për të marrë kopje në formë shkresore në faqen e internetit të shoqërisë. Për çdo ndërprerje të përkohshme të mundësisë për të hyrë në faqen e internetit të shoqërisë, për arsye teknike apo arsye të tjera, afati njëmuajor i publikimit ndërpritet dhe do të rinis nga e para në momentin kur faqja e internetit të shoqërisë bëhet sërish e arritshme.”.

NENI 43

ZMADHIMI I KAPITALIT

43.1 Në rast se shoqëria do të jetë në pozicionin e shoqërisë përthithëse zmadhimi i kapitalit të regjistruar, që kryhet në kuadër të bashkimit, nuk do të nënshtrohet parashikimeve që lidhen me:

- a) ndalimin e zmadhimit derisa të kryhen pagesat e pashlyera për kuotat/aksionet e nënshkruara më parë;
- b) kushtet për nënshkrimin e kuotave/aksioneve të reja;
- c) të drejtat e parablerjes nga aksionarët/ortakët të aksioneve/kuotave të reja.

NENI 44

REGJISTRIMI, PUBLIKIMI DHE PASOJAT

44.1 Përfaqsesi/Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që do të marrin pjesë në bashkim, do të njoftojnë bashkimin për regjistrim pranë **Qendrës Kombëtare të Biznesit**, së bashku me marrëveshjen e bashkimit, procesverbalin e asamblesë për miratimin e bashkimit, si dhe procesverbalin për miratimin e ortakëve/aksionarëve të veçantë. Sipas rastit, informacioni i lartpërmendur do të publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë/shoqërive, nëse ka.

44.2 Nëse shoqëria është në pozicionin e shoqërisë përthithëse dhe nëse kapitali i regjistruar i shoqërisë rritet, në kuadër të bashkimit, vlera e zmadhimit do të njoftohet së bashku me bashkimin.

44.3 Regjistrimi i bashkimit të shoqërisë/shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit:

- a) në rast se shoqëria është në pozicionin e shoqërisë përthithëse ka pasojë kalimin e të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që përthithet. Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe te palët e treta;
- b) bën që aksionarët apo ortakët e shoqërisë së përthithur të bëhen aksionarë apo ortakë të shoqërisë përthithëse;
- c) bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet, pa kaluar në procesin e likuidimit.

NENI 45

MBROJTJA E KREDITORVE

45.1 Kreditorët e shoqërisë, në momentin që shoqëria do të marrë pjesë në një bashkim, brenda 6 muajve nga publikimi i projekt marrëveshjes së bashkimit, sipas nenit 220 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, do të paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve të tyre, shoqëria do t'u japë garanci të mjaftueshme për kreditë e tyre. Garanci e mjaftueshme për kreditorët do të vlerësohet deklarata me shkrim, e dhënë nga përfaqsesi/përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, që do të marrin pjesë në bashkim, ku do të pranohet se pasuritë e shoqërisë/shoqërive do të

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

administrohen në mënyrë të veçuar deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithë kreditorëve. Nëse kjo garanci nuk do të jepet nga përfaqësuesi/përfaqësuesit ligjorë të shoqërisëshoqërive, kreditorët mund t'i kërkojnë gjykatës.

45.2 Kreditorët e siguruar të procedurës së falimentit nuk kanë të drejtë të kërkojnë garancinë e përmendur në pikën 45. 1 të këtij neni.

45.3 Përfaqësuesi/Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që bashkohen, do të përgjigjen në mënyrë solidare për të gjitha dëmet e shkaktuara kreditorëve, si pasojë e pasaktësisë së deklaratës së përmendur në fjalinë e dytë të pikës 45.1 të këtij neni.

NENI 46

MBROJTJA E ZOTËRUESVE E TË DREJTAVE TË VEÇANTA

46.1 Shoqëria përthithëse detyrohet t'u garantojë zotëruesve të obligacioneve të konvertueshme e të aksioneve me përparësi të njëjtat të drejta, që këta gëzonin në shoqërinë e përthithur.

NENI 47

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË ORTAKVE DHE AKSIONERVE

47.1 Kur aksionarët apo ortakët e shoqërive që bashkohen nuk japin pëlqimin për bashkim, atëherë këta kanë të drejtë të kërkojnë nga shoqëria blerjen me vlerë tregu të aksioneve apo kuotave të zotëruara të tyre nga shoqëria që rezulton nga bashkimi, apo në rast mosmarrëveshesh, me çmimin e përcaktuar nga një ekspert vlerësues i pavarur, i emëruar nga gjykata me kërkesë të këtyre aksionarëve apo ortakëve. Në mënyrë alternative, aksionarët mund të kërkojnë që shoqëria përthithëse të këmbëjë aksionet e tyre me përparësi pa të drejtë vote, me aksione me të drejtë vote. Janë të zbatueshme dispozitat e Kodit të Procedurës Civile për kundërshtimet e palëve gjatë procesit të ekspertimit.

48.2 Të drejtat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni duhet të ushtrohen brenda 60 ditëve nga data e publikimit të bashkimit për shoqërinë përthithëse, sipas nenit 220 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

NENI 48

PËRGJEGJËSIA E ORGANEVE TË ADMINISTRIMIT, TË ORGANEVE MBIKQYRËSE DHE EKSPETËVE

48.1 Administratori/Administratorët, e shoqërisë përthithëse përgjigjen solidarisht, bashkë me shoqërinë përthithëse, për dëmet që ortakët, aksionarët dhe kreditorët e shoqërive, që marrin pjesë në bashkim, kanë pësuar nga ky veprim, me përjashtim të rasteve kur ata provojnë se i kanë përmbushur rregullisht detyrimet ligjore, të lidhura me vlerësimin e pasurive të shoqërive dhe me procedurat e përsosjes së marrëveshjes së bashkimit.

48.2 Administratori/Administratorët, të shoqërisë së përthithur, si dhe ekspertët e pavarur të licencuar, të angazhuar në vlerësimin e bashkimit, përgjigjen për të njëjtat shkaqe e me të njëjtat kushte, sipas pikës 48.1 të këtij neni.

48.3 Në të dyja rastet, paditë si më sipër duhen ngritur brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të bashkimit të shoqërisë përkatëse.

KREU X

BASHKIMI ME KRIJIMIN E NJË SHOQËRIE TË RE

NENI 49

DISPOZITAT E ZBATUESHME

49.1 Dispozitat e neneve 40 deri 48 ose 216 deri në 225 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar zbatohen edhe në rastin e bashkimit me

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

themelim të një shoqërie të re.

KREU XI NDARJA

NENI 50

PËRKUFIZIMI, DISPOZITAT E ZBATUESHME

50.1 Shoqëri ndahet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria nëse ndahet, vlerësohet e prishur.

50.2 Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e këtij statuti dhetë neneve 216 deri në 225 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

50.3 Nëse shoqëria ndahet, dhe shoqëritë që do të fitojnë pasuritë e kësaj të fundit do të përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

50.4 Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë do të behet pranë **Qendrës Kombëtare të Biznesit** ka si pasojë:

- a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;
- b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- c) vlerësimin e shoqërisë “ndahet”, të prishur dhe çregjistrimin e saj, pa kryerjen e likuidimit.

KREU XII SHNDËRRIMI

NENI 51

DISPOZITATË PËRGJITHSHME

51.1 Shoqëria tregtare mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit, si më poshtë:

- a) shoqëria mund të shndërrohet nga shoqëri me përgjigjësi të kufizuar në shoqëri aksionare nga shoqëri aksionare me ofertë private në një shoqëri aksionare me ofertë publike dhe anasjelltas, nëse do të përmbushen kërkesat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe të ligjit për titujt.

51.2 Shndërrimi nuk do të sjellë pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

NENI 52

PROÇEDURA

52.1 Administratori/Administratorët e shoqërisë, në rast shndërrimi, do të hartojnë një raport të hollësishëm, ku shpjegohen bazat ligjore dhe ekonomike të shndërrimit të propozuar. Në raport do të përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat janë hasur. Raporti duhet të përshkruajë edhe efektin, që do të ketë shndërrimi të punëmarrësit e shoqërisë.

52.2 Vendimi për shndërrimin e shoqërisë do të merret nga asambleja e përgjithshme, me

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

një shumicë prej tre të katërtave. Nëse shndërrimi do të ketë si pasojë ndryshimin e të drejtave dhe të detyrimeve të veçanta të aksionarëve apo ortakëve, atëherë vlefshmëria e vendimit për shndërrim do të nënshtrohet miratimit të aksionarëve apo ortakëve të prekur, pikës 2 të nenit 218 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

52.3 Administratori/Administratorët do të thërrasin të gjithë aksionarët apo ortakët, që nuk kanë qenë të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhjen e asamblesë, ku është vendosur shndërrimin, duke u kërkuar të deklarojnë me shkrim nëse e pranojnë apo jo shndërrimin e shoqërisë, sipas vendimit përkatës. Thirrja e aksionarëve apo ortakëve do të bëhet me shpallje, e cila do të publikohet pranë **Qendrës Kombëtare të Biznesit** dhe në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, dy herë, me intervale të ndërmjetëm prej jo më pak se 15 ditëve dhe jo më shumë se 30 ditësh. Aksionarët/ortakët e thirrur do të duhet të depozitojnë në selinë e shoqërisë deklaratën me shkrim brenda 60 ditëve nga publikimi i fundit i thirrjes.

52.4 Publikimi i shpalljes së përmendur në pikën 52.3 3 të këtij neni nuk është i detyrueshëm, kur në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme kanë qenë të pranishëm ose të përfaqësuar të gjithë aksionarët/ortakët apo kur mbledhja e asamblesë së përgjithshme u ishte njoftuar individualisht aksionarëve/ortakëve në mungesë. Në rastin e fundit, afati 60-ditor nis nga data e marrjes së njoftimit të mbledhjes. Miratimi i shndërrimit vlerësohet i dhënë nëse aksionarët/ortakët nuk e deklarojnë qëndrimin e tyre me shkrim brenda afatit të caktuar.

52.5 Për mbrojtjen e kreditorëve, zotëruesve të të drejtave të veçanta dhe titullarëve të interesave, të cilët e kundërshtojnë shndërrimin, do të zbatohen përkatësisht nenet 221, 222 e 223 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

52.6 Për përgjegjësitë ligjore të përfaqësuesve ligjorë, për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre, gjatë kryerjes së shndërrimit, zbatohen, përkatësisht, dispozitat e nenit 224 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

52.7 Shndërrimi do të njoftohet për regjistrim pranë **Qendrës Kombëtare të Biznesit**, së bashku me vendimin e shndërrimit, procesverbalin e asamblesë së përgjithshme për vendimin e shndërrimit, dokumentet e vendimit të aksionarëve të veçantë dhe të aksionarëve, të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në mbledhjen e asamblesë.

52.8 Regjistrimi i shndërrimit të shoqërisë pranë Biznesit do të bëjë që:

- a) Në rast se shoqëria shndërrohet, do të vazhdojë të ekzistojë në formën ligjore, të përcaktuar në vendimin e shndërrimit;
- b) Në rast se shoqëria shndërrohet aksionarët/ortakët, të marrin pjesë në shoqëri, sipas kushteve të përcaktuara në ligj, për formën e re të shoqërisë;
- c) të drejtat e personave të tretë për aksionet e shoqërisë, të vazhdojnë të zbatohen edhe për aksionet në rast se shoqëria shndërrohet.

KREU XIII

VITI FINANCIAR DHE DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 53

53.4 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 54

54.1 Në rast se dispozitat e këtij statuti bien ndesh me ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 ,“Për

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar apo ndonjë ligj tjetër do të rishikohen që të jenë në përputhje me to ose do të hfuqizohen.

54.2 Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Durrës.

ORTAKËT
ESHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
DEDJA&SALILLARI SHPK
Z. Bashkim SALILLARI

